



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr.211/20**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina- Kryetar, z. Nuhi Paçarizi-Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: "I.P.N.EU" SH.P.K. & "Infra-plus" SH.P.K. & "Noti-Beton" SH.P.K.-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorëve ekonomik: "Tali" SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët" me nr. të prok. 651-19-698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "Komuna e Gjilanit", më datë: 24.04.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: "I.P.N.EU" SH.P.K. & "Infra-plus" SH.P.K. & "Noti-Beton" SH.P.K. -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët" me nr. të prok. 651-19-698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Gjilan.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët" me nr. të prok. 651-19-698-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "Komuna e Gjilanit". Dhe lënda kthehet në Rivleresim.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik ankues "I.P.N.EU"SH.P.K.&"Infra-plus" SH.P.K &"Noti-Beton" SH.P.K.-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Grupi i operatorëve ekonomik ankues "I.P.N.EU"SH.P.K.&"Infra-plus" SH.P.K &"Noti-Beton" SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.03.2020 me nr. 211/ 20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: "Tali" SH.P.K. – Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal në rrugën e Kumanovës deri te lumi në Livoçin e ulët" me nr. të prok. 651-19-698-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/"Komuna e Gjilanit", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:7, 28.2, 52.1, 56, 58.3, 59.2 dhe 5, 60.1.1 si dhetë Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.04.2020, ka autorizuar ekspertinshqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.04.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

**Përgjigjej në Pretendimi nr.1.** Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, pika 1 e nenit 52, neni 56, pika 3 e nenit 58, pika 2 dhe 5 e nenit 59 dhe neni 72 i LPP-së, me arsyetimin se:

"-Ne jemi te diskriminuar nga A.K. fillimisht nga moment te cilin procesverbalin e hapjes nuk na kanë ngarkuar ne e-prokurim 17.05.2019 te cilin kanë dashur te mbajnë sekret kur ka qenë hapja, mirëpo pas kërkesës me 11.07.2019 ne email na është përcjellë.

-Veprimi nga A.K. me Vendimin e dt. 12.07.2019 ku na keni shpallur te sipas letrës për eliminim si te përgjegjshëm d.th. pa vërejte.



-Veprimi nga A.K. me Vendimin e dt. 20.11.2019 ku na keni shpallur te papërgjegjshëm me arsye se nuk e kemi bere validitetin dhe sigurimin e tenderit e cila nuk ka qëndruar d. th.nuk i keni propozuar dëshmitë si ne vijim te paraqitura, dhe gjatëkërkesës përrishqyrtim e keni pranuar lëshimin dhe prapë keni gjetur arsye për eliminim e qe ne konsiderojmë qe nuk qëndron e gjithë kjo bije ndeshë me LPP Nr.04/L-042 te amandamentuara, Përkatësisht Nenet e cekur me Lartë.

-Veprimi nga A.K. me Vendimin e dt. 09.03.2020 ku na keni shpallur te papërgjegjshëm me arsye se nuk e kemi bere Listën e pajisjeve me en-minut por vetëm te noterizuara e qe konsiderojmë qe nuk qëndron arsye.

-Prandaj ne kërkojmë nga zyra e juaj përkatësisht ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT që te anuloj vendimin e dt 09.03.2020 dhe te na lejohet e drejta si fitues.”

duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe me letrënstandarde për tenderuesin e eliminuar te datës 20.11.2019 ka njoftuar grupin e OE ankuese se janë eliminuar nga kyaktivitet i prokurimit me arsyetimin se:

“Me datë 27.02.2020 e enjte AK-Komuna e Gjilanit ka Kërkuar Sqarim Shtesë duke ju referuar: Në Dosjen e Tenderit si dhe në Njoftimin për Kontratë tek FTD, gjegjësisht të Kërkesat mbi mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale është kërkuar Kërkesa 4. Operatori Ekonomik duhet të posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit dhe si Dëshmia 4- Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve, Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit Lista e pajisjeve duhet të jetë e notorizuar nga noteri me procedura en-minutes. Ju së bashku me ofertën tuaj për ta plotësuar këtë Kriter keni dorëzuar Listën e Pajisjeve të Noterizuar, mirëpo nga AK është kërkuar që Lista e Pajisjeve të jetë e Noterizuar me Procedura EN-MINUTE.

Meqë, AK- Komuna e Gjilanit ka pranuar Vendimin përfundimtar të OSHP-së dhe në bazë të këtij vendimi me nr. të Protokolit Nr. 874/19 të datës 14.01.2020 është kërkuar që AK që gjatë fazës së Rivlerësimit të Kërkojë Informatë Shtesë në Harmoni me nenin 72 të LPP-së. Andaj, AK kërkon ju që nëse e posedoni Listën e Pajisjeve të Noterizuar me Procedura EN MINUTE ta sjellni tek AK.

Si përfundim, ju si OE keni sjellë përmes emalit me datë 29.02.2020 përgjigjen për Kërkesën që ju kemi adresuar juve. Mirëpo, Komisioni Profesional i Vlerësimit ka shqyrtuar Përgjigjen tuaj dhe kjo e fundit nuk ka qenë aspak bindëse pasi përkundër që është kërkuar Sqarim Shtese ju nuk e keni sjellë Kërkesën ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit si dhe në Njoftimin për Kontratë. Gjithashtu, vlen të ceket se në Ofertën tuaj figuron vetëm Vërtetim fakti mbi ofrimin e dokumentacionit Original për të Vërtetuar Kopje identikë me Originalin dhe si i tillë shpalleni të pa përgjegjshëm, pasi që procedurën EN-MINUTE nuk e keni përmbushure sipas kërkesës 4, të FTD-së dhe në Përgjigjja juaj nuk përputhet me Kërkesën nr. 4 të FTD-së..” Nga fakti i paraqitur më lartë respektivisht nga arsyeja e eliminimit të OE ankuese e përshkruar



më lartë konstatohet fakti se nuk qëndron pretendimi i grupit të OE ankuese, se e njëjta është eliminuar nga AK, me arsyen se “nuk e ka bërë vazhdimin e validitetin dhe sigurimin e tenderit”.

Eksperti Shqyrtues konstaton se AK me rastin e rivlerësimit të ofertave në zbatim të Vendimit të PSH 874/19 dt.14.01.2020 si dhe konformë nenit 59 dhe 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarim shtesë nga grupi i OE ankuese lidhur me “*Listën e Pajisjeve*” e cila nuk është dorëzuar konformë kërkesës së parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, si vijon: “Lista e pajisjeve duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedura en-minutes”

Grupi i OE ankuese së bashkë me dosjen e tenderit ka bashkangjitur, listën e makinerisë dhe kopjet e dëshmimeve për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që i ka në dispozicion për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit të vërtetuar tek noteri, mirëpo nuk e ka dorëzuar listën e pajisjeve të noterizuar sipas procedurës en-minutes, po ashtu me rastin e kërkesës për sqarim nga AK, grupi i OE ankuese ka dorëzuar me datë 29.02.2020 një përgjigje sqaruese por jo edhe listën e pajisjeve të noterizuara nga noteri me procedurën en-minutes, siç e ka kërkuar AK me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe me “letrës standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit” të datës 27.02.2020.

Po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se përkundër që në ligjin për noterin nr.06/L-010 nuk ekzistojnë emërtimet e akteve en-minute dhe en-brevet, në praktikë noterët i përpilojnë aktet noteriale me njërin nga këto emërtime, një fakt i tillë konstatohet edhe me listën e pajisjeve të bashkangjitura nga OE i rekomanduar për kontratë si dhe listën e pajisjeve të disa operatorëve ekonomik tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit të cilët aktet noteriale për listat e pajisjeve i kanë të përpiluara dhe të emërtuar si akte en-minute.

**Përgjigja në pretendimin 2.** Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje paragrafin 1.1 të nenit 60 të LPP-së, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit të lëndës eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i operatorit ekonomik ankues **nuk është i bazuar** sepse ashtu siç u cek në përgjigjen e pretendimit nr.1, grupi i OE ankues nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe dëshmitë siç janë kërkuar nga AK me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë si dhe bazuar në paragrafin 1.1 të nenit 60 të LPP-së” *Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.”*

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të hudhet poshtë si e bazuar, si dhe rekomandon që të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës, i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 06.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 08.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.



Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 24.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicitimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtruesat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e ngritur sa i përket eliminimit të OE ankues bazuar në letrën standarde të tenderuesit të eliminuar (OE ankues) të dt. 12.07.2019 me arsyetimin e AK-se se nuk e ka vazhduar vlefshmërinë e ofertës - validitetin (90 ditë) dhe sigurisë së ofertës (120), paneli shqyrtues konstaton se ky në rastin konkret kemi të bëjmë me pretendime të përsëritura i cili është trajtuar më parë nga OSHP e paraprakisht edhe nga AK e cila gjatë fazës së shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të OE ankues ka konstatuar se ky pretendim është i vlefshëm si rrjedhojë e të cilit AK ka marrë masa adekuate korrigjuese që ndryshojnë nga vlerësimi i dhënë në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar me këtë arsye të dt. 12.07.2019. Prandaj paneli shqyrtues duke u bazuar në gjendjen faktike sipas vendimit PSH. 874/19 të dt. 14.01.2020 dhe konform nenit 105 par. 2 pika 16 të LPP-së dhe nenit 16 pika 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së, për arsyet e cekura këtë çështje e trajton si çështje të gjykuar “Res Juridicata”. Për këto arsye ky pretendim ankimor është i bazuar.

Po ashtu parashtruesi i ankesës OE I.P.N. “EU” Sh.p.k & “Infra Plus” Sh.p.k. & “Noti Beton” Sh.p.k. përmes pretendimit të radhës e ka kontestuar vendimin e AK-së përkatësisht letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të dt. 11.03.2020 i cili është nxjerrë pas procedurës së sqarimit të tenderit të OE ankues si rrjedhojë e ri-vlerësimit të ofertave në zbatim të vendimit të OSHP-së PSH.nr. 874/19. AK parashtruesin e ankesës e ka eliminuar me arsyen se: *“...Gjithashtu vlen të ceket se në ofertën tuaj figuron vetëm vërtetim fakti mbi ofrimin e dokumentacionit Origjinal për të vërtetuar Kopje identike me Origjinalin dhe si e tillë shpalleni të pa përgjegjshëm, pasi që procedurën EN-MINUTE nuk e keni përmbushë sipas kërkesës 4, të FTD-së dhe në përgjigja e juaj nuk përputhet me Kërkesën nr. 4 të FTD-së.*

Paneli shqyrtues sqaron se për të plotësuar kërkesën e AK-së të nenit 9.1 të FTD-së tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesa nr. 4 lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit dhe OE duhet t'i plotësojnë në nenin 9.2, Dëshmia 4 është kërkuar: *Dëshmi mbi pronësinë (apo te marrjes me qira) te mjeteve, Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit Lista e paisjeve duhet te jetë e notorizuar nga noteri me procedura en-minutes.. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit”*



Bazuar në faktet dhe provate e shqyrtuara, paneli ka gjetur se parashtruesi i ankesës për ta plotësuar kërkesën në fjalë gjatë tenderimit së bashku me dosjen e tenderit ka bashkëngjitur listën e makinerisë dhe kopjet e dëshmimeve për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që i ka në dispozicion për realizimin e projektit të vertetuara tek noteri, mirëpo lista nuk është e noterizuar në formën siç është kërkuar “*En minute*” në kërkesën “*Dëshmia 4*” të kërkesës 9.2 lidhur me kërkesën 9.1 të FTD-së të dosjes së tenderit por ky akt noterial është bërë në formën me emërtimin “*Vërtetim fakti mbi ofrimin e dokumentacionit origjinal për të vërtetuar kopjet identike me origjinalin*”. Po ashtu edhe me rastin e kërkesës për sqarim të AK-së të dt. 27.02.2020, parashtruesi i ankesës me dt. 29.02.2020 ka dorëzuar një përgjigje sqaruese duke ju referuar të njetit akt por jo edhe Listën e paisjeve të noterizuara nga noteri me procedurën “en-minute” siç është kërkuar në kërkesën Dëshmia 4 të pikës 9.2 të FTD-së së dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se në bazë të nenit 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 4 të LPP-së, si kusht që një tenderues të jetë i përgjegjshëm parashikohet se: “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit*”.

Në rastin konkret për të plotësuar kërkesën nga neni 9.1&9.2, kërkesa/dëshmia 4 nga AK është kërkuar “*Lista e paisjeve duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedura en-minutes..*” Në anën tjetër OE ankues për ta plotësuar kërkesën në fjalë ka dorëzuar një dokument noterial me emërtimin “*Vërtetim fakti mbi ofrimin e dokumentacionit origjinal për të vërtetuar kopjet identike me origjinalin*”. Karrshi kësaj çështje konform ekspertit profesional të prokurimit në bazë të Ligjit për Noterinë nr. 06/L-010 nuk ekzistojnë emërtimet e akteve en-minute dhe en-brevet mirëpo në praktikë noterët i përpilojnë aktet me këto emertime siç konstatohet në ratsin konkret me listën e paisjeve të OE fitues dhe OE tjerë pjesëmarrës.

Prandaj paneli shqyrtues duke u bazuar në gjendjen faktike dhe juridike të pasqyruar si më lartë dhe duke pasur në konsideratë se parashtruesi i ankesës lidhur me kërkesën në fjalë e ka dorëzuar një dokument noterial me një emërtim tjetër por jo siç është kërkuar në dosjen e tenderit, paneli shqyrtues obligon AK që gjatë ri-vlerësimit në pajtim me nenin 72 të LPP-së lidhur me çështjen në fjalë të kërkojë sqarime shtesë nga noteri që ka lëshuar këtë akt noterial se grupi i OE I.P.N. “EU” Sh.p.k & “Infra Plus” Sh.p.k. & “Noti Beton”

1. A ka prezentuar në zyrën e noterit dokumentacionin origjinal që konfirmon pronësinë, posedimin (qiramarrjen) e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike siç kërkohen në nenin 9.1, kërkesa 4 të FTD –së të dosjes së tenderit lidhur me realizimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë;
2. Në bazë të dokumentacionit të prezentuar para noterit a ka dalur noteri në vendin e ngjarjes (selinë e grupit të OE ankues) për të shikuar dhe konstatuar se këto mjete a janë në pronësi, posedim apo shfrytëzim të grupit të OE ankues

3. Akti noterial “Vërtetim fakti mbi ofrimin e dokumentacionit original për të vërtetuar kopjet identike me origjinalin” a i përmban konstatimin e gjendjes juridike “en-minute” dhe konstatimin e gjendjes faktike për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë kërkuar për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlersimi dhe krahasimi i ofertave duhet të bëhet konform nenit 59 të LPP-së dhe dhënia e kontratës të bëhet në pajtim rigoroz sipas parimeve kryesore të procedurës së vlerësimit. Njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit të veproj konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së si dhe të shpërblehet me kontratë Operatori Ekonomik që i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të publikuara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen t’i përmbahet në detaje vendimit të panelit shqyrtues dhe si dhe të gjitha dispozitave të LPP-së

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t’i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
z. Blerim DINA



#### **Vendimi t’i dorëzohet:**

- 1x1 AK- “Komuna e Gjilanit”
- 1x1 GOE“I.P.N.EU”SH.P.K&“Infra-plus” SH.P.K& “Noti-Beton” SH.P.K- Prishtinë,,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.